


A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Prill
2021



Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës

A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb të Kosovës – Në mes të perceptimit dhe prezantimit

Partitë politike të serbëve të Kosovës në sistemin politik të Kosovës: Nga pluralizmi deri te monizmi

Qëndrimet e Serbëve të Kosovës mbi institucionet e sigurisë

Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

Titulli i hulumtimit: A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Botues: KFOS

Për botuesin: Bota bardh e zi – CBS (Crno beli svet) dhe Qendra e Mediale në Çagllavicë

Autore: Snezhana Gjapiq

Gjuha origjinale në të cilën është punuar analiza është gjuha Serbe

Përkthimi në gjuhën shqipe: Xhenana Azizi

Dizajni: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): tedel (100)

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatat Bota bardh e zi - CBS dhe Qendra e Mediale në Çagllavicë. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

Viti i botimit: 2021

PËRMBAJTJA

01.

PËRSHKRIMI I GJENDJES DHE ZBULIMI I PROBLEMIT 6

- a) Cila është gjendja në fushën e mediave 6
- b) Çfarë ndryshimesh po ndodhin, cilat janë trendet 8
- c) Cilët janë akterët e rëndësishëm dhe cilat janë rolet e tyre 8
- d) Cilat janë problemet kryesore 10

02.

QËLLIMI I HULUMTIMIT DHE METODOLOGJIA KËRKIMORE (SASIORE + CILËSORE) 12

- a) Qëllimi i hulumtimit 12
- b) Përshkrimi i modelit metodologjik dhe ndërlidhja e tij me qëllimin e hulumtimit 12

03.

REZULTATET E HULUMTIMIT DHE KONTEKSTUALIZIMI I TYRE 15

- Audienca - mënyra e informimit dhe besimit në media 15
- Interesat dhe zakonet e audiencës 19
- Qëndrimet në lidhje me punën dhe besimin në media 22
- Gjuha e urrejtjes 29
- Siguria e gazetarëve 31
- Pandemia Covid-19 dhe mediat 33

04.

PËRFUNDIMET 36

05.

REKOMANDIME 38

Rekomandimet e përgjithshme 38

Rekomandime për media 38

Rekomandime për institucione 39

1. Përshkrimi i gjendjes dhe zbulimi i problemit

a) Cila është gjendja në fushën e mediave

Puna e mediave në Kosovë është e rregulluar nga një numër aktesh ligjore. Duke filluar me lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias të garantuar me kushtetutë¹ përmes ligjeve që rregullojnë fushën e raportimit mediatic në mënyra të ndryshme, të tilla si puna e transmetuesit publik, mbrojtja e privatësisë, gjuha e urrejtjes, shpifjet dhe fyerjet, e drejta e autorit². Lëvizjet pozitive në përmirësimin e legjislationit në sferën e mediave prezantohen me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike dhe rishikimin e Ligjit për Shërbimin e Transmetimit Publik³ sepse janë zhvilluar në një procedurë transparente dhe me përfshirjen e përfaqësuesve të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, organizatave joqeveritare, ekspertëve dhe dëgjimeve publike.

Skena mediatike në Kosovë është e ngarkuar me shumë probleme. Raporte të shumta ndërkom-bëtare dhe vendase që bëjnë vlerësimin e situatës

në media dhe lirinë e shprehjes tregojnë se ka ende mungesë të "zbatimit efektiv të garancive ligjore për disa arsye: burime joadekuate dhe kapacitete të pamjaftueshme të institucioneve përkatëse, mungesa e vullnetit politik dhe zbatimi selektiv, procedura të ngadalta administrative, etj.⁴" Sipas indeksit të Reporterëve pa Kufij, i cili mat rrezikun e ushtrimit të profesionit të gazetarit, Kosova në listën prej 180 vendeve, nga vendi i 75-të në 2019 u ngjiti në vendin e 70-të në vitin 2020⁵. Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian tregon se Kosova po arrin një nivel të caktuar të përgatitjes, por që "institucionet e sundimit të ligjit duhet të vazhdojnë përpjekjet për të ndërmarrë veprime përcjellëse për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve. Transmetuesi publik mbetet i prekshëm nga ndikimi politik dhe ende mbetet të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për financimin e tij⁶". Të dhënat e fundit nga Indeksi i Freedom House për vitin 2019 lirinë e shprehjes në Kosovë e vlerëson me 2 nga maksimumi 4, duke theksuar se qeveria dhe ekonomia ndikojnë në politikat redaktoriale, përfshirë RTK, dhe se gazetarët shpesh raportojnë kërcënime

1 <http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Ustav1.pdf>, neni 40

2 Ligji Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës; Ligji Civil Nr. 02/L-65 kundër shpifjes dhe fyerjes; Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave; Ligji Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike; Ligji Nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë; Ligji Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve

3 <http://agk-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/KOS-SRB-2019.pdf>, faqe 10

4 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2019, Bruksel, f. 25. i qasshëm: 18 tetor 2019: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-Kosovo-report.pdf>, cituar sipas <http://agk-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/KOS-SRB-2019.pdf> faqe 9

5 <https://kossev.info/reporteri-bez-granica-srbija-pala-na-93-mesto-kosovo-se-popelo-na-70/>

6 Raporti i KE për Kosovën: Bëni përpjekje në dialog me Serbinë dhe zbatoni reformat (glasamerike.net)

dhe presione⁷. Në Indeksën e Qëndrueshmërisë së Mediave të IREX, Kosova me një rezultat të përgjithshëm prej 2.53 në vitin 2019 pati një rënie të vogël krahasuar me indeksin 2.56 në 2018 dhe u vlerësua si "afër qëndrueshmërisë"⁸ (near sustainability në tekstin origjinal).

Vështirësitë e përmendura si të përbashkëta për të gjitha mediat janë ndikimi i politikës, financimi jo transparent, tregu i pazhvilluar i reklamimit mediatic, përkatësisht ndikimet në RTK si transmetues publik, të cilat nuk janë zgjidhur me rregullim të financimit të pavarur të punës së tij. Rastet e gazetarëve të zhdukur dhe të vrarë nga viti 1998 deri në 2005 janë ende të pazgjidhura, përkundër iniciativave të shumta nga Asociacioni i Gazetarëve të Serbisë në Kosovë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ose organizata ndërkombëtare, veçanërisht Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Nuk ka informata më të hollësishme për situatën në mediat serbe në Kosovë, sidomos jo në mënyrë sistematike. Shtojca 1 e këtij raporti paraqet një listë të mediave aktive që raportojnë në gjuhën serbe. Gjithsej janë 48 media aktive, nga të cilat 8 televizione, 21 radio stacione dhe 13 portale në internet dhe 6 video produksione. Një pjesë e mediave bashkëpunon përmes 3 rrjeteve, rrjeti Kosma (Kosma mreža), rrjeti Most (Mreža Most) dhe rrjeti i pavarur TV (Nezavisna TV mreža).

Ka disa burime informacioni në zonat e populluara nga serbët e Kosovës. Qytetarët kanë qasje në përmbajtjen mediatike nga mediat kosovare që raportojnë në gjuhën serbe, mediat në gjuhën shqipe nga Kosova, si dhe mediat nga Serbia. Në një situatë të tillë, mediat serbe nga Kosova nuk janë në pozitë të barabartë për sa i përket kapacitetit prodhues, si për nga lloji ashtu edhe për nga sasia e përmbajtjes që prodhojnë në baza ditore.

Në shumicën e rasteve, mediat në gjuhën serbe në Kosovë janë të regjistruara në Komisionin e

Pavarur të Mediave⁹ sipas Ligji Nr. 04 / L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe mund të ndahen në:

- Mediat e themeluara nga shteti (ndërmarrjet publike ose transmetuesit publik)
- Mediat komerciale (të krijuara me iniciativë sipërmarrëse të pronarëve të tyre)
- Mediat që funksionojnë si organizata joqeveritare të regjistruara
- Korrespondentët ose korrespondencat e mediave ose agjencive selia e të cilave është në Beograd ose jashtë vendit
- Produksionet lokale audio - vizuale që transmetojnë programin e tyre të prodhuar përmes mediave partnere dhe përmes internetit.

Raportimi mediatic mbulon më së miri Kosovën qendrore dhe atë veriore, dhe mbulimi më i dobët është në rrafshin e Dukagjinit, Gorë (ku jetojnë goranët dhe boshnjakët që flasin gjuhën serbe, përkatësisht boshnjake) dhe në komunën e Zubin Potokut. Njëjtë mund të vlerësohet edhe puna e mediave në terren. Më së shumti raportohet nga Kosova qendrore dhe veriore, si dhe nga rrafshi i Kosovës, dhe më pak nga Siriniqu, rrafshi i Dukagjinit, Gora dhe komuna e Zubin Potokut.

Sipas metodave të financimit, mediat serbe ndahen në ato që financohen nga:

- Remitancat e planifikuara financiare nga buxheti i Serbisë (JP Mreža Most)
- Fondet e alokuara nga Ministria e Kulturës dhe Informacionit të Republikës së Serbisë në bazë të konkursit për bashkëfinancim të mediave elektronike
- Fondet e alokuara në bazë të një konkursi nga Zyra për komunitete në kuadër të kabinetit të Kryeministrit të Kosovës
- Remitancat e planifikuara financiare nga buxheti i Kuvendit të Kosovës (RTK2)
- Donacionet e organizatave ndërkombëtare

⁷ <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2020>, pjesa D1

⁸ <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-full.pdf>, faqe 55

⁹ <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/1335250532.0606.pdf>

dhe ambasadat e huaja në bazë të projekteve (donatorët më të mëdhenj për mediat në gjuhën serbe deri më tani kanë qenë: OSBE, UNDP, USAID, NED, BTD, KFOS dhe ambasada e Norvegjisë, SHBA-së, Gjermanisë, Britanisë së Madhe, etj.)

- Sponsorizimet (minimale dhe të parëndësishme)
- Të ardhurat nga reklammat (minimale dhe të parëndësishme)

b) Çfarë ndryshime po ndodhin, cilat janë trendet

Të gjitha të dhënat e dala nga hulumtimi tregojnë një trend të polarizimit në mesin e mediave serbe në Kosovë. Ky fenomen theksohet nga qytetarët në fokus grupe, si dhe përfaqësuesit e mediave (pronarë, gazetarë dhe redaktorë) ose përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

Ekziston një ndarje e fortë për mediat që financohen nga buxheti dhe që punojnë me forma të ndryshme të mbështetjes nga autoritetet lokale ose mbështeten nga Serbia dhe shtëpitë e pavarura mediatike me financimin përmes donacioneve për zbatimin e projektit. Të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim theksojnë këtë ndarje kur flasin për aspekte të ndryshme të punës së tyre, të tilla si temat me të cilat merren, të dhënat dhe burimet në bazë të të cilave raportojnë, siguria në punë ose shkalla e hapjes dhe tolerancës për opinione të ndryshme ose akterë të ndryshëm.

Sipas ekspertëve të fushës së mediave, kjo ndarje shihet si një trend që me kalimin e kohës po thellohet dhe për shkak të të cilit mediat e pavarura janë në një pozitë gjithnjë e më të vështirë kur bëhet fjalë për qëndrueshmërinë e punës së tyre. Varëshmëria nga donatorët dhe financimi i projektit është një faktor që e komplikon punën në kuptim të pamundësisë së financimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë, pra nevojës që aktivitetet mediatike të planifikohen dhe formohen në përputhje me kërkesat dhe fushat e mbështetura përmes programeve të donatorëve. Gjithashtu, kjo mënyrë e punës çon në nevojën për ndryshime në redaksitë në mënyrë

që mediat të kenë një nevojë gjithnjë e më të zhvilluar për ndarje të përgjegjësisë midis pjesës gazetareske dhe asaj administrative-financiare të punës. Meqenëse këto janë kryesisht redaksi më të vogla, kapacitetet ekzistuese duhet t'i kushtohen administrimit të projekteve, gjë që rëndon edhe më tej punën e tyre në dëm të punës gazetareske dhe hetimore.

c) Cilët janë akterët e rëndësishëm dhe cili është roli i tyre

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka rolin më të rëndësishëm në sigurimin e pluralizmit në raportim. KPM është organi kryesor rregullator i pavarur që "lëshon licenca për transmetuesit publik dhe privat, miraton dhe zbaton politikat e transmetimit dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e individëve dhe personave juridikë që ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuale.¹⁰" Vërejtjet për punën e këtij organi kanë të bëjnë me thjeshtësinë e procedurës dhe kërkesat minimale për regjistrimin e mediave, zgjedhjen e anëtarëve të BD-së nga Kuvendi i Kosovës, si dhe vonesat në inicimin e rasteve dhe aplikimin e gjobave për shkelje të ligjit¹¹. Nën autoritetin e këtij organi janë radio stacionet dhe stacionet televizive.

Këshilli i mediave të shkruara¹² është përgjegjës për respektimin e kodit të mediave të shkruara dhe standardeve gazetareske në median e shkruar, si dhe në portalet e internetit.

Ligji rregullon gjithashtu ekzistencën e transmetuesit publik (TP) ose RTK-së si transmetues publik. Rregulloret në lidhje me transmetuesin publik janë në pritje të ndryshimeve për shumë vite, veçanërisht në drejtim të sigurimit të pavarësisë së nevojshme, e cila aktualisht lidhet plotësisht me financimin e shtetit.

10 <https://www.kpm-ks.org/sr/kpm/311/per-kpm/311>

11 <http://agk-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/KOS-SRB-2019.pdf>, faqe 10

12 <http://presscouncil-ks.org/o-nama/?lang=sr>



Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka rolin më të rëndësishëm në sigurimin e pluralizmit në raportim. KPM është organi kryesor rregullator i pavarur që “lëshon licenca për transmetuesit publik dhe privat, miraton dhe zbaton politikat e transmetimit dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e individëve dhe personave juridikë që ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuale.

RTK2 është kanal në gjuhën serbe i krijuar në vitin 2012 dhe puna e tij rregullohet me Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës¹³. Ligji garanton alokimin e 10% të buxhetit të transmetuesit publik për funksionimin e këtij kanali. Ndryshimet në Ligjin për RTK-në për pjesën e dispozitës së parimeve u miratuan në vitin 2019¹⁴, por nuk u votuan në Kuvendin e Kosovës dhe si rrjedhojë kjo dispozitë u hoq. Duke miratuar një zgjidhje të tillë ligjore, funksionimi i kanalit në gjuhën serbe do të ishte i pasigurt, sikurse mbijetesa e tij dhe e ardhmja e punonjësve.

RTK2 u krijua në bazë të nenit 59 të Kushtetutës së Kosovës (të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre) sipas të cilit pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:

“(Paragrafi 11): të krijojnë dhe të përdorin mediat e tyre vetjake, përfshirë këtu ofrimin e informacioneve në gjuhën e tyre, ndër të tjera, përmes gazetave ditore e shërbimeve kabllore, dhe përdorimin e një numri të rezervuar të frekuencave për mediet elektronike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Republika e Kosovës do të marrë

¹³ https://www.rtklive.com/rtk2-arhiva/rtk/etc/rtk_uredba.pdf

¹⁴ <https://www.radiokontaktplus.org/vesti/danas-razmatran-naact-zakona-o-rtk/19910>

të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e një plani ndërkombëtar të frekuencave, për t'i mundësuar komunitetit Serb në Kosovë qasje në një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën Serbe, në mbarë Republikën e Kosovës¹⁵.”

Kyçe këtu është se AGS në Kosovë, si dhe shumë qytetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, madje edhe politikanë serbë besojnë se serbët në Kosovë, duke themeluar RTK 2, nuk morën atë që u takon sipas nenit 59 paragrafi 11 i Kushtetutës së Kosovës.

Pra, përkundër kundërshtimit të komunitetit të mediave serbe në Kosovë dhe punës së publikut profesionist vendas dhe të huaj, dhe të tjerëve që propozuan një kanal të pavarur televiziv publik jashtë transmetuesit publik të Radio Televizionit të Kosovës, deputetët e Kuvendit të Kosovës, me mbështetjen e deputetëve nga Partia e Pavarur Liberale, në vitin 2012 miratuan Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës me të cilin është i paraparë një kanal në gjuhën Serbe - RTK2. Shumë shpejt, RTK2 u formua si pjesë e RTK-së, me mbështetje redaktoriale dhe teknike në qendër të Prishtinës, dhe që atëherë transmetohet përmes operatorëve kabllorë në dispozicion në jug të lumit Ibër.

Pas miratimit të Ligjit për RTK, komuniteti i mediave serbe reagoi ashpër, duke theksuar se kanali RTK2 nuk mund të konsiderohet si realizim i dispozitës kushtetuese për një kanal të pavarur në gjuhën serbe dhe që nga ajo kohë në mënyrë të vazhdueshme dhe argumentuese potencion dëmet e zgjidhjes ekzistuese, njëkohësisht duke mos hequr dorë nga e drejta që i takon komunitetit serb.

Gazetarët, të mbledhur në Asociacionin e Gazetarëve Serb në Kosovë që inicio idenë e krijimit të një stacioni televiziv në gjuhën serbe, ishin kundër zgjidhjeve të imponuara për disa arsye:

- Zgjidhja ekzistuese, sipas tyre, nuk garanton që kanali në gjuhën serbe do t'i përkasë komunitetit serb, siç parashikohet me

¹⁵ http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/06/USTAV_REPUBLIKE_KOSOVO.pdf, faqe 18.

Kushtetutën e Kosovës (dispozita për kanalin në gjuhën serbe nuk është në pjesën e parimeve të përgjithshme të së drejtës për informim dhe lirisë së shtypit, por në një kapitull të veçantë "Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre", si e drejtë specifike që i përket komunitetit serb);

- Zgjidhja ekzistuese nuk e përmbush zgjidhjen e dakorduar që sinjali televiziv të mbulojë tërë Kosovën sepse ky kanal transmetohet përmes transmetuesve kabllorë dhe nuk mbulon veriun e Kosovës.
- Zgjidhja ekzistuese nuk garanton që kanali do të jetë i pavarur (si nga aspekti i redaksisë, teknik, të programit, të personelit, si dhe nga aspekti financiar).

Një aktor i rëndësishëm në mbështetjen e mediave dhe gazetarëve është Asociacioni i Gazetarëve të Serbisë në Kosovë, i cili përmes punës shumë vjeçare, ndikon në përmirësimin e pozitës dhe mbrojtjen e gazetarëve. Përveç kësaj, asociacioni rregullisht lëshonte një sërë komunikatash për shtyp që potenconin ose dënonin sulmet ndaj gazetarëve serbë dhe mediave serbe, si dhe në raste të tjera kur të drejtat e njeriut ose të drejtat profesionale të mediave, dhe e drejta për përdorim të barabartë të gjuhës në Kosovë ishin shkelur ose cenuar.

Sipas mendimit të tyre, një nga sukseset e AGS në Kosovë është kryesisht çështja e përkthimit në ngjarjet publike të organizuara nga institucionet e Kosovës, ku në shumicën e rasteve nuk kishte përkthim në gjuhën serbe, megjithëse sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, gjuha serbe është një nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Pas disa viteve të palodhshme pune, protestave të ndryshme dhe theksimit të këtij problemi, kjo çështje është zgjidhur pjesërisht, por ka ende raste kur të drejtat e gazetarëve për të përdorur gjuhën serbe nuk respektohen.

AGS në Kosovë në mënyrë aktive insiston tek institucionet ndërkombëtare dhe vendore në zgjidhjen e çështjes së fatit të gazetarëve të zhdukur, si dhe zbulimin e rasteve të gazetarëve të vrarë në peri-



Një aktor i rëndësishëm në mbështetjen e mediave dhe gazetarëve është Asociacioni i Gazetarëve të Serbisë në Kosovë, i cili përmes punës shumë vjeçare, ndikon në përmirësimin e pozitës dhe mbrojtjen e gazetarëve.

dhën 1998-2005, ku u vranë dhe rrëmbyen gjithsej 17 gazetarë.

Ky asociacion ka një bashkëpunim aktiv dhe të suksesshëm me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës AGK në Kosovë. Aktivitetet e përbashkëta që synojnë përmirësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve në Kosovë janë të shpeshta. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Lirisë së Shtypit, më 3 maj, AGS dhe AGK organizuan protesta të përbashkëta në Graçanicë dhe Prishtinë.

d) Cilat janë problemet kryesore

Duke pasur parasysh situatën komplekse në të cilën veprojnë, e cila reflektohet në problemet e shumta politike dhe ekonomike me të cilat përballen shoqëria kosovare, mund të themi se funksionimi i mediave serbe në Kosovë shoqërohet me një numër të konsiderueshëm të vështirësive.

Financimi jo-transparent i buxhetit është një problem kryesor dhe përcakton plotësisht kushtet dhe mënyrat për punën e mediave, dhe si pasojë ka një pabarazi të konsiderueshme në pozicionin e shtëpive mediatike. Ndarja e mediave është një problem i cekur nga të gjithë pjesëmarrësit në humlumtim, pavarësisht nëse vijnë nga mediat, OJQ-të ose janë qytetarë. Ndarja sipas mediave të financuara nga fondet e buxhetit lokal dhe fondet nga Serbia (kryesisht nga Zyra për Kosovë) dhe mediave të pavarura kryesisht me financim nga projekti ceket si një përcaktues kryesor që prek të gjitha segmentet e punës, nga zgjedhja e temave

dhe mënyrave të përpunimit të tyre, burimeve të informacionit dhe disponueshmërisë së akterëve kyç politikë të rëndësishëm për raportimin e ngjarjeve dhe proceseve si në komunitetin serb ashtu edhe në shoqërinë kosovare në tërësi.

Mediat që mbështeten me financim nga fondet e donatorëve janë në një pozitë shumë më të pafavorshme sepse puna dhe kapacitetet e tyre kushtëzohen drejtpërdrejt nga projektet. Si rezultat, këto media nuk kanë kapacitete të mjaftueshme, ballafaqohen kryesisht me mungesë të gazetarëve në redaksitë, gjë që i kufizon në ndjekjen e temave që mbulojnë dhe aftësinë për të mbuluar në mënyrë më të thelluar dhe sistematike proceset që janë të rëndësishme për shoqërinë dhe qytetarët.

Një problem tjetër madhor me të cilin përballen mediat serbe në Kosovë, kryesisht mediat e pavarura, është mosdisponueshmëria e vazhdueshme e përfaqësuesve të institucioneve dhe autoriteteve lokale dhe qendrore për komente. Lidhur me disponueshmërinë e informacionit nga institucionet, gazetarët tregojnë për vështirësitë në marrjen e informacionit nga institucionet kryesisht në nivelin lokal, ndërsa marrëdhënia me institucionet qendrore ende shoqërohet me probleme me dokumentet zyrtare në gjuhën serbe, të cilat, edhe pse të garantuara në disa raste nuk ekzistojnë ose janë përkthyer në mënyrë joadekuate. Pamundësia për të marrë përgjigje në kohë dhe të dhëna të besueshme dhe zyrtare ndikon në punën gazetareske dhe çon në privimin e qytetarëve për informim përkatës, dhe kështu zvogëlon besueshmërinë e punës gazetareske.

Dominimi i politikës në të gjitha segmentet e jetës në Kosovë reflektohet edhe në punën e mediave. Zhvillimet politike, kryesisht ato në nivelin ndërkombëtar në lidhje me bisedimet me Serbinë dhe pozicionin e komunitetit serb në Kosovë, janë prioritet në raportim dhe përbëjnë pjesën më të rëndësishme të produksionit mediatik. Në një situatë të tillë ku politika është tema kryesore në lidhje me jetën e qytetarëve dhe e cila pritet të zgjidhë proceset afatgjata, të kombinuara me kapacitet



Dominimi i politikës në të gjitha segmentet e jetës në Kosovë reflektohet edhe në punën e mediave. Zhvillimet politike, kryesisht ato në nivelin ndërkombëtar në lidhje me bisedimet me Serbinë dhe pozicionin e komunitetit serb në Kosovë, janë prioritet në raportim dhe përbëjnë pjesën më të rëndësishme të produksionit mediatik. .

të kufizuar, mediave u mbetet shumë pak hapësirë për të trajtuar tema të tjera si jeta e përditshme, storjet e njerëzve që do i vendosin qytetarët në fokus, ose ngjarjet dhe problemet e komunitetit shumicë. Përfaqësuesit e mediave theksojnë se është e nevojshme që qytetarëve t'u paraqiten storje pozitive dhe të suksesshme lokale, të përafrohet jeta e njerëzve nga zona të tjera, jeta e shumicës së popullsisë ose shembuj të bashkëpunimit të ndërsjellë.

2. Qëllimi i hulumtimit dhe metodologjia kërkimore (sasiore + cilësore)

a) Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor i hulumtimit në fushën e mediave është të përcaktojë shkallën në të cilën mediat në gjuhën serbe në Kosovë ndikojnë në shkallën e hapjes, qasjes dhe pluralizmit të opinioneve dhe temave në komunitetin e tyre. Pyetja kryesore e hulumtimit ishte: A janë dhe deri në çfarë mase janë të hapura mediat serbe në Kosovë për tema dhe opinione të ndryshme?

b) Përshkrimi i modelit metodologjik dhe ndërlidhja e tij me qëllimin e hulumtimit

Duke pasur parasysh rëndësinë e informacionit objektiv, të vërtetë dhe në kohë, si kusht i rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë dhe formimin e qytetarëve që janë në gjendje të kuptojnë fenomenet, proceset dhe funksionimin e komuniteteve, analiza përmes segmenteve të ndryshme u përpoq të paraqesë kornizën e mediave serbe në Kosovë, sfidat që ndikojnë në hapjen dhe aftësinë e tyre për të kontribuar në dialogun social. Gjetjet e analizës dhe hulumtimit të qëndrimeve të qytetarëve dhe përfaqësuesve të mediave do të shërbejnë si një kontribut për nismën Open për zhvillimin e një hapësire të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, midis serbëve

dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë. Gjetjet do të jenë një bazë e vlefshme për përfaqësim të argumentuar ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverive lokale dhe qendrore, si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

● METODOLOGJIA E HULUMTIMIT CILËSOR

Hulumtimi i ndikimit të mediave për hapjen dhe demokratizimin të shoqërisë ka përfshirë përdorimin e një larmie teknikash kërkimore.

Përmes mbledhjes sekondare të të dhënave (desk research) u vërtetua korniza ligjore që rregullon punën dhe pavarësinë e mediave në Kosovë, u ofrua një pasqyrë e të dhënave nga institucionet që merren me mediat, si dhe u paraqitën analizat dhe indekset në lidhje me liritë e mediave dhe lirinë e shprehjes.

INTERVISTA GJYSMË TË STRUKTURUARA

- gjithsej 13 intervista u zhvilluan me gazetarë, redaktorë dhe pronarë të mediave serbe, si dhe përfaqësues të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare që merren me çështjet e lirisë së shprehjes dhe punës së mediave. Gjatë intervistës, u mblodhën të dhëna për qëndrimet në lidhje me kushtet në të cilat punojnë mediat (korniza për punë dhe zbatimin e saj),

disponueshmëria e burimeve, fushëveprimi, mundësitë ekzistuese që përveç informimit me-diat të kenë funksionin e hapjes më të madhe të shoqërisë, si dhe kufizimet me të cilat përballen në punën e tyre.

GRUPET E FOKUSIT - gjatë hulumtimit, u mba-jtën gjithsej tre grupe të fokusit, dy në veri të Kosovës dhe një në jug. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit ishin qytetarë, gazetarë dhe përfaqësues të

OJQ-ve. Numri mesatar i pjesëmarrësve në grupet e fokusit ishte gjashtë. Bisedat zgjatën mesatar-isht një orë e gjysmë. Përmes grupeve të fokusit u identifikuan qëndrimet në lidhje me punën e me-diave për sa i përket hapjes ndaj opinionëve dhe temave të ndryshme, perceptimet e qytetarëve për ato tema dhe cilët janë akterët që duhet të jenë prezentë më shumë në media, si dhe reko-mandimet për mediat me qëllim të një kontributi më të madh në demokratizimin e shoqërisë.

GRUPET E FOKUSIT

Periudha:

Hulumtimi u realizua në periudhën nga 15.10.2020 deri më 20.11.2020.

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues bisede

Numri i grupeve të fokusit:

3 grupe të fokusit

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:

16 pjesëmarrës (mesatarisht 5 pjesëmarrës për fokus grup)

Kriteret për zgjedhjen e pjesëmarrësve:

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit u zgjedhën bazuar në kriteret e mëposhtme: gjinia, mosha, vendbanimi, punësimi (këtu u përpoqëm të përfshijmë të punësuar në institucione publike, sektorin privat, por edhe sektorin civil dhe mediat).financiare

INTERVISTAT

Periudha:

Hulumtimi u realizua në periudhën nga 15.10.2020 deri më 25.11.2020.

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues për intervistë

Numri i përgjithshëm i të intervistuarve:

14 të intervistuar

Kriteret për zgjedhjen e bashkëbiseduesve:

bashkëbiseduesit ishin gazetarë, korrespondentë, redaktorë, pronarë të mediave, përfaqësues të donatorëve dhe sektorit civil.

● METODOLOGJIA E HULUMTIMIT SASIOR

1	Periudha:	Hulumtimi u realizua në periudhën nga 1 tetori deri më 20 tetor 2020.
2	Metoda e mbledhjes së të dhënave:	Ballë për ballë (F2F), studim në terren (D2D)
3	Metoda e kontrollit të punës së intervistuesve:	Google maps (GPS) live location sharing
4	Lloji:	Letër dhe laps
5	Instrumenti i hulumtimit:	Pyetësi i anketës i përbërë nga 65 pyetje
6	Mostra:	mbi 18 vjeç
7	Lloji i mostrës:	Qëllimi, kuota.
8	Kriteri i përcaktimit të kuotave:	Madhësia e komunës sipas numrit të popullsisë sipas kuotave të paracaktuara për komunat dhe vendbanimet në jug (287/300) dhe në veri të lumit Ibër (295/300)
9	Madhësia e mostrës:	582 të anketuar me vendbanim në komunitetin serb në Kosovë
10	Intervali i besimit:	+/- 5% për dukuri me një incidencë të pritur prej 50%
11	Deklaratë për mosmbajtje përgjegjësie:	Duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flasim për përfaqësim të mostrës së këtij hulumtimi.

3. Rezultatet e hulumtimit dhe kontekstualizimi i tyre

Me qëllim të paraqitjes gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale të mediave serbe, puna e tyre u analizua përmes segmenteve të ndryshme si audiencia (mënyrat e informimit të qytetarëve dhe besimi në media, interesimi për tema të ndryshme, perceptimi i përmbajtjes mediatike) dhe siguria e gazetarëve si një element që ndikon në lirinë në punë.


Audiencia - mënyra e informimit dhe besimi në media

Një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e ndikimit të mediave serbe në Kosovë është sjellja e audiencës, përkatësisht mënyrat e informimit të qytetarëve. Përveç mediave nga komuniteti i tyre, qytetarët e komunitetit serb gjithashtu kanë qasje në mediat nga Serbia, mediat shqiptare dhe të huaja. Burimi dominues i informacionit për shumicën e qytetarëve janë mediat nga Beogradi. Nga këto media informohen plotësisht rreth 43.5% e të anketuarve dhe kryesisht 47.20%. Mediat serbe nga Kosova në përgjithësi janë një burim i rëndësishëm informacioni për 18.9% të qytetarëve dhe 45.6% e tyre kryesisht i përdorin këto media për t'u informuar.

Këto të dhëna nuk janë për t'u habitur sepse mediat nga Beogradi përfaqësojnë një burim tradicional të informimit, veçanërisht për të moshuarit që kryesisht mbështeten në informacionet e

RTS. Një faktor tjetër që kushtëzon zakone të tilla të informimit është shumëllojshmëria e formateve mediatike që ekzistojnë, sepse mediat serbe nga Kosova nuk mund të garojnë me shtëpitë e mëdha mediatike dhe produktionet e tyre, veçanërisht në programet artistike ose dokumentare. Përfaqësuesit e mediave konsiderojnë se mund të bëhet një dallim në informim i cili nëse ka të bëjë me tema lokale drejtohet nga mediat nga Kosova, ndërsa fusha të tilla si politika ndërkombëtare, ngjarjet botërore ose programet argëtuese bazohen kryesisht në mediat nga Serbia.


Një numër dukshëm më i vogël i qytetarëve (3% plotësisht dhe 11% kryesisht) mbështeten në informacionin nga mediat e huaja, që kryesisht janë të anketuarit e rinj dhe më të arsimuar. Mediat në shqip janë burimi më pak i përdorur i informacionit dhe përdoren kryesisht nga 6.5%, ose 0.8% e pjesëmarrësve në hulumtim.

Grafiku 1. Paraqitja e rezultateve në pyetjen "Nga cilat media informoheni më shpesh?"

Sa i përket vendbanimit, kishte dallime dominuese në mënyrën e informimit, kështu që të anketuarit nga komunat në jug të Ibrit në 47.6% të rasteve plotësisht informohen nga mediat në Beograd, ndërsa një përqindje pak më e ulët është në me-

sin e të anketuarve që jetojnë në veri të Kosovës 39.3%. 21.3% e të anketuarve nga veriu i Kosovës dhe 16.6% e të anketuarve nga komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër plotësisht informohen nga mediat serbe të Kosovës.

Grafiku 2. Paraqitja e rezultateve në pyetjen "Nga cilat media informoheni më shpesh? - shpërndarja e përgjigjeve sipas vendbanimit"



Televizioni është burimi më dominues i informimit ditorë rreth politikës. 45.5% e qytetarëve deklarojnë se për politikë informohen çdo ditë përmes televizionit, ndërsa një e treta e numrit të përgjithshëm të të anketuarve përdorin gazeta online (31.1%) ose lajme në internet, ueb faqe ose blogje (32.3%). Këto mënyra gjithashtu dominojnë te

përgjigjet në lidhje me informimin e herëpashërshtëm rreth politikës shprehur përmes numrit të ditëve të përdorimit në javë. Radio dhe shtypi janë mënyrat më të rralla të informimit për politikë, kështu që rreth 48.2% deklarojnë se asnjëherë nuk informohen përmes radios dhe 36.5% nga shtypi.

Tabela 1. Në tre muajt e fundit, mesatarisht, sa ditë në javë jeni informuar për politikë nga lloje të ndryshme të burimeve mediatike, të tilla si:

	N	1	2	3	4	5	6	S	NO
Gazeta të shtypura	36,5	11,5	6,1	4,4	2,6	3,3	1,5	6,7	0,5
Radio	48,2	14,3	12,4	8,5	5,9	3,5	1,2	5,9	0,1
Televizioni	8,1	6,1	4,5	8,7	8,1	9,6	9,5	45,5	0
Gazetat online	23,1	6,4	7	6,9	7,1	9,8	7	31,1	1,6
Lajmet në internet, ueb faqe ose blogje	24,4	5	6,6	7,1	8,5	7,4	8	32,2	0,9


N - asnjëherë; **1** - 1 ditë në javë; **2** - 2 ditë në javë; **3** - 3 ditë në javë; **4** - 4 ditë në javë;
5 - 5 ditë në javë; **6** - 6 ditë në javë; **S** - çdo ditë; **NO** - pa përgjigje; vlerat janë të shprehura në %.

Besimi në media është i ndërlidhur me të dhënat për burimet e informacionit, d.m.th. besimi më i madh u tregohet mediave nga Serbia. Pothuajse tre të katërtat e të anketuarve shprehin besim në këto media, 50% e qytetarëve deklarojnë se kanë besim dhe 22.8% të tjerë kanë besim të plotë në informacionin që vjen nga këto media. Qytetarët gjithashtu tregojnë besim shumë të lartë në mediat serbe nga Kosova, 8.8% e tyre kanë besim të plotë, dhe 57.8% e pjesëmarrësve në hulumtim shprehin besim në raportim.

Mosbesimi më i madh mbizotëron ndaj informacionit nga mediat në gjuhën shqipe (62.1% nuk besojnë aspak, dhe 22.3% e të anketuarve kryesisht nuk besojnë), këto të dhëna duhet të interpretohen në kontekstin e barrierës gjuhësore, pra,

pamundësisë për të kuptuar përmbajtjen e publikuar nga këto media. Një numër i vogël i teksteve të përkthyer arrijnë te qytetarët, përkatësisht kjo ende përfaqëson një burim të paarritshëm të informacionit për qytetarët e komunitetit serb në Kosovë. Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, ndërmjet një të katërtës dhe një të tretës, nuk u besojnë mediave që raportojnë në gjuhën serbe. Mosbesimi pak më i lartë është shprehur ndaj mediave lokale (10.4% aspak nuk besojnë dhe 22.3% kryesisht nuk besojnë) sesa ndaj mediave nga Serbia (7.1% aspak nuk besojnë dhe 19.3% kryesisht nuk besojnë), gjë që duhet të jetë një nxitje për mediat lokale, kryesisht për ato të financuara nga buxheti që të punojnë për të rikthyer besimin e audiencës.

Grafiku 3. Sa besim keni në mediat e mëposhtme?



Interesat dhe zakonet e audiencës


Interesi më i madh individual i qytetarëve ka të bëjë me çështjen e zgjidhjes së statusit të Kosovës, 47.5% janë shumë të interesuar dhe 24.7% janë të interesuar për informacion mbi këtë temë. Ky informacion ishte i pritshëm duke pasur parasysh kohëzgjatjen e këtij procesi dhe rëndësinë e madhe që kjo temë ka për qytetarët. Përfaqësuesit e mediave gjithashtu pajtohen me këtë të dhënë, duke theksuar se çështja e statusit është shumë e rëndësishme për banorët e Kosovës të komunitetit serb sepse lidhet drejtpërdrejt me pozitën dhe realizimin e të drejtave të komunitetit serb. Në thelb ky proces nuk është i njohur për qytetarët dhe kanë pritje të mëdha, sepse procesi duhet të sigurojë një kornizë në të cilën do të funksionojnë serbët, domethënë

duhet të sigurojë mekanizma për ushtrimin e të drejtave të tyre në të gjitha segmentet e jetës.

Qytetarët tregojnë interes pothuajse identik për politikën e brendshme në Serbi. Afro një e treta e të anketuarve, 30.1% e tyre janë shumë të interesuar dhe 44% janë kryesisht të interesuar për t'u informuar mbi këtë temë. Sipas mendimit të përfaqësuesve të mediave, ky interesim i lartë mund të interpretohet nga lidhjet e ngushta me Serbinë, përkatësisht fakti që Serbia dhe përfaqësuesit e saj janë pjesëmarrës aktivë në procesin e dialogut, dhe për këtë arsye qytetarët kanë pritje të mëdha prej tyre, përkatësisht shprehin interesim për ata që negociojnë në emër të tyre, pra që mund të ndikojnë në rezultatin përfundimtar të bisedimeve dhe në këtë mënyrë në pozitën e tyre.

Interesimi i konsiderueshëm shfaqet gjithashtu për temat ekonomike (70.3% janë disi të interesuar dhe të interesuar), për pandeminë e koronavirusit (61.2% janë disi të interesuar dhe të interesuar), politikën e brendshme në Kosovë (74.1% janë disi të interesuar dhe të interesuar), dhe për politikën e brendshme në Serbi (58.4% disi të interesuar dhe të interesuar). Rëndësia e informacionit në lidhje me këto tema njihet nga gazetarët dhe redaktorët e mediave serbe nga Kosova.

Grafiku 4. prezantimi i shpërndarjes së interesimit të të anketuarve sipas informacionit dhe temave të caktuara në media




Në segmentin e ndjekjes së përmbajtjes mediatike, qytetarët dhanë përgjigje se sa ndjekin tema të ndryshme nga jeta politike që janë të defnuara si të rëndësishme për jetën dhe punën e tyre. Ndër temat që qytetarët i ndjekin plotësisht, pra, që ndiqen më së shumti nga ta, veçohen këto: dialogu midis Beogradit dhe Prishtinës, çështjet ekonomike (vendet e punës dhe pagat), marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve dhe ngjarjet në Qeverinë e Kosovës. Një fakt interesant është ndjekja e konsiderueshme e debateve në të cilat marrin pjesë politikanë serbë, ose politikanë serbë dhe shqiptarë. Këto të dhëna, së bashku me të dhënat e marra nga gazetarët dhe redaktorët tregojnë se ka shumë pak debate në të cilat politikanët shkëmbejnë pikëpamje, dhe se shikuesit dhe dëgjuesit janë të interesuar për këtë lloj të përmbajtjes mediatike dhe janë të lumtur t'i ndjekin ato kur janë në dispozicion.

Gazetarët dhe redaktorët e intervistuar thonë se qytetarët janë të interesuar për tema ekonomike, pra për të gjitha informacionet që lidhen me (mundësitë) e punësimit, standardet e jetesës dhe zhvillimin ekonomik sepse janë drejtpërdrejtë të ndërlidhura me cilësinë e jetës. Ajo që përfaqësuesit e mediave e perceptojnë në bazë të asaj që shihet dhe lexohet nga mediat e tyre është informacioni në lidhje me

pandeminë si një fenomen që ndikoi ndjeshëm në jetën e qytetarëve për sa i përket rreziqeve shëndetësore, por edhe një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre të përditshme në drejtim të funksionimit, lëvizjes dhe ndikimeve (negative) në rritje ekonomike. Gjithashtu, informatat për shërbime komunale dhe lokale konsiderohen nga të gjitha kategoritë e të anketuarve si më të rëndësishmet, pra, është pjesa më e rëndësishme e informacionit të kërkuar në mediat lokale. Ajo që deklarojnë përfaqësuesit e mediave si nevojë janë storjet pozitive lokale në formën e artikujve ose reportazheve për bashkëqytetarët e suksesshëm. Sukseset e të rinjve në sport, idetë e suksesshme të biznesit, shembujt e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve serbë, dhe serbëve me komunitete tjera janë përmbajtje që janë të pranueshme për qytetarët. Në këtë mënyrë, qytetarëve u sigurohet një largim nga ngarkesa politike dhe ngjarjet politike që lidhen me proceset afatgjata.

Grafiku 5. Monitorimi i temave në media që raportojnë në gjuhën serbe



Nga ana tjetër, ato tema të cilave qytetarët nuk u kushtojnë vëmendje janë debate midis politikanëve shqiptarë (85%), ngjarje në Kuvendin e Kosovës (69.8%) ose ngjarje në Qeverinë e Serbisë (68.2%).


Qëndrimet në lidhje me punën dhe besimin në media

Në këtë kapitull, ne do të paraqesim perceptimin e qytetarëve dhe përfaqësuesve të mediave në lidhje me punën dhe besimin në media. Përmes segmenteve të ndryshme siç janë vërtetësia e raportimit, favorizimi i palëve të caktuara, neglizhimi i temave ose akterëve të caktuar, shikimi kritik i temave dhe fenomeneve nga kënde të ndryshme, hapja ndaj temave dhe qëndrimeve të ndryshme, si dhe neglizhimi dhe mos raportimi për çështje të caktuara të rëndësishme. U përpoqëm të identifikonim pikëpamjet mbizotëruese në punën e mediave serbe në Kosovë. Këto të dhëna mund të përdoren si bazë mbi të cilën shtëpitë mediatike dhe përfaqësuesit e tyre mund të kuptojnë më mirë preferencat e audiencës së tyre dhe të identifikojnë fushat dhe qa-

sjet me përmirësimin e të cilave mund t'i qasen në mënyrë më adekuate dhe më receptive për-punimit dhe prezantimit të përmbajtjes së tyre para audiencës. Në këtë mënyrë, mediat do të marrin informacione mbi aspektet që qytetarët i shohin si problematike, pra aspekte që kërkojnë përmirësime të mëtejshme.

Pak më pak se gjysma e qytetarëve besojnë se media transmetojnë informacion të vërtetë (8.5% pajtohen plotësisht dhe 37% pajtohen me këtë deklaratë). Pak më shumë se një e treta e të anketuarve, nga ana tjetër, nuk kanë besim në vërtetësinë e raportimit. Një numër i konsiderueshëm i qytetarëve nuk mund të shprehin pikëpamjet e tyre për këtë çështje. Kjo është një e dhënë e rëndësishme për mediat sepse tregon nevojën për ngritjen e besimit të qytetarëve në media.

Grafiku 6. Besoj se mediat transmetojnë informacion të vërtetë



Qytetarët dhe përfaqësuesit e mediave që morën pjesë në grupet e fokusit janë të mendimit se këto të dhëna pasqyrojnë pikëpamje reale sepse sipas tyre ekziston një ndarje e konsiderueshme midis mediave dhe vërtetësisë së raportimit të tyre. Ekspertët dhe përfaqësuesit e mediave theksojnë se raportimi i mediave, veçanërisht ato që financohen në mënyrë të pavarur, bazohet në informacione të vërteta dhe të verifikuara dhe se deri më tani nuk ka pasur raste të publikimit të informacionit të rremë ose informacionit që përfaqëson në mënyrë të paqartë ngjarje të caktuara.

Gazetarët dhe redaktorët deklarojnë se gazetarët dhe mediat e pavarura janë të kujdesshme në punën e tyre, me kujdes të veçantë të paraqesin të dhëna për audiencën, veçanërisht kur bëhet fjalë për tema të tilla si politika lokale, dialogu ose marrëdhëniet midis serbëve dhe shqiptarëve, sepse këto tema janë të ndjeshme dhe mund të çojnë në nxitje të intolerancës ose ngatërresa midis qytetarëve. Komplexiteti i situatës politike dhe historia e marrëdhënieve midis dy komuniteteve është një faktor i rëndësishëm që ndikon në raportim të kujdesshëm dhe jo tendencioz, veçanërisht mbi temat politike.

Matim çdo fjalë. Gjuha duhet të zgjidhet me kujdes, çfarë do të thuhet, në mënyrë që të mos dëmtojë ndjenjat e dikujt. Ka më pak të pavërteta në krahasim me mediat nga Serbia ose ato nga Prishtina. Gazetarët janë më të kujdesshëm. Ndoshta sepse janë në mes dy zjarreve. (redaktore, Mitrovica)

Kryesisht transmetojmë qëndrimin dhe jo lajmin, diçka që është zbuluar. Dhe këtu është e vështirë të flasësh për pavërtetësi sepse ka të bëjë kryesisht me përcjelljen e deklaratave ose përgjigjeve. Nuk ka lajme të rrejshme, shumë pak. (gazetare, Prishtinë)


Pak më shumë se gjysma e qytetarëve pajtohen me qëndrimin se informacioni që ata marrin nga media është i njëanshëm, d.m.th. se ata favorizojnë një palë të caktuar gjatë raportimit. Përveç të dhënave për mosbesimin e lartë në vërtetësinë e raportimit, mediat, kryesisht ato të financuara nga buxheti, duhet të punojnë për të rikthyer besimin e qytetarëve në punën e tyre. 13% e të anketuarve

pajtohen plotësisht, dhe 39.6% pajtohen me qëndrimin e deklaruar.

Për gazetarët dhe redaktorët gjithashtu një segment problematik është puna e mediave të financuara nga buxheti, përkatësisht ai që ka të bëjë me raportimin mbi punën e politikanëve lokal dhe institucioneve lokale. Ekzistojnë opinione se raportimi dominohet nga transmetimi i deklaratave ose komunikatave nga politikanët, institucionet dhe organizatat pa parashtrim të pyetjeve. Një pjesë e qytetarëve në fokus grupe mendojnë se mediat e financuara nga buxheti janë të angazhuara kryesisht në transmetimin e deklaratave, kështu që në një qasje të tillë nuk mund të flitet për vërtetësinë ose jo të informacionit.

Qytetarët në një masë më të madhe besojnë se informacioni i marrë nga media është i njëanshëm, pra, se në raportim favorizojnë një palë të caktuar. Gjithsej 52.6% e qytetarëve pajtohen që ekziston paragjykimi, ndërsa rreth një e treta e të anketuarve deklarojnë se nuk pajtohen (25.4%) ose nuk pajtohen aspak (6.3%) me këtë qëndrim. Qytetarët dhe gazetarët janë të mendimit se mediat e financuar nga buxheti favorizojnë pikëpamjet dhe opinionet e autoriteteve lokale dhe institucioneve zyrtare.

Grafiku 7. Konsideroj se informacioni nga mediat është i njëanshëm, favorizon një palë të caktuar




Ndarja e mediave serbe në Kosovë mbështetet gjithashtu nga të dhënat mbi perceptimin e raportimit në politikë, ku disa media neglizhojnë tema të caktuara, përkatësisht nuk i përpunojnë nga më shumë kënde. Në mediat e financuara nga buxheti deklaratat e përfaqësuesve të qeverisë ose institucioneve nuk rishikohen, nuk ka kërkime për vërtetim të deklaratave, vënie në pah të mospërpunuesve me situatën në terren, ose ballafaqim të akterëve me të dhëna ose dokumente që mund të demantojnë deklaratat në televizion. Pjesëmarrësit e hulumtimit besojnë se mediat e pavarura ofrojnë një perspektivë më të gjerë, veçanërisht në portale

përmes analizave të thella, duke botuar komente nga analistë dhe ekspertë të komunitetit serb dhe shqiptar, duke përkthyer analiza ose artikuj nga shtypi në shqip ose artikuj hulumtues dhe tematikë.

Pak më shumë se gjysma e qytetarëve tregojnë neglizhencë për tema të caktuara kur bëhet fjalë për politikë (nga gjithsej 55.7% të qytetarëve 15.5% pajtohen plotësisht, dhe 40.3% pajtohen me pretendimin e ofruar). Vetëm një e katërta e të anketuarve besojnë se nuk ka neglizhim të temave në raportim të politikave. Mungesa e qëndrimit ndaj kësaj çështje theksohet nga 10.9% e pjesëmarrësve në hulumtim.


Grafiku 8. Kur bëhet fjalë për politikë dhe ngjarje politike, disa tema tjera injorohen plotësisht nga mediat



Situata është gjithashtu e polarizuar, por disi më e favorshme, kur është në pyetje perceptimi i trajtimit kritik të temave dhe perceptimi i tyre nga kënde të ndryshme, në krahasim me perceptimin e raportimit për tema politike. 30.1% e të anketuarve pajtohen, dhe 7% plotësisht pajtohen me qëndrimin se mediat përpiqen të japin përmbledhje kritike për

temat të cilat i raportojnë. Përqindja e atyre që nuk pajtohen (38.2%) është pothuajse identike, gjë që mund të shërbejë si një imperativ për mediat sepse qytetarët identifikojnë dhe kërkojnë një perspektivë më të larmishme në përpunimin dhe prezantimin e temave në media. 16% e të anketuarve nuk kanë një qëndrim të qartë për këtë temë.


Grafiku 9. Kur raportojnë për një ngjarje, mediat përpiqen ta trajtojnë storjen në mënyrë kritike nga disa këndvështrime



Hapja e mediave serbe në Kosovë ndaj personave dhe ideve të caktuara është aspekti i vlerësuar në mënyrën më negative. Më shumë se gjysma e qytetarëve që morën pjesë në anketim pajtohen (38.8%) ose plotësisht pajtohen (14.7%) me qën-

drimin e hapjes së pamjaftueshme të mediave. Ekziston një përqindje dukshëm më e ulët e atyre që nuk pajtohen (20.1%) ose nuk pajtohen fare (6.6%) me këtë qëndrim.

Grafiku 10. Mediat nuk janë të hapura ndaj personave të caktuar, e as ndaj ideve të caktuara



Audienca profesionale në lidhje me hapjen e mediave gjithashtu insiston në ndarjen në fjalë midis mediave. Sipas mendimit të tyre, mediat e financuara nga buxheti tregojnë një shkallë mjaft të ulët të hapjes ndaj temave, bashkëbiseduesve dhe opinionëve që ndryshojnë nga qëndrimet zyrtare të strukturave qeverisëse. Përmbajtja dominuese ka të bëjë kryesisht me punën e autoriteteve lokale, transmetimin e qëndrimeve zyrtare të autoriteteve lokale ose serbe, veçanërisht për çështje që lidhen me dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës dhe aspekte të ndryshme me bisedimet e Brukselit. Qytetarët në fokus grupe besojnë se megjithëse zëri i përfaqësuesve të pushtetit lokal mund të dëgjohet në media që janë në favor të tyre, por që ka pak mundësi t'i shohin ata drejtpërdrejt, pra nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në emisione. Në këtë mënyrë, edhe mediat, të cilat kanë mundësi t'iu qasen politikaneve, nuk kanë mundësi të bisedojnë me ta.

Nga ana tjetër, për sa i përket hapjes ndaj opinionëve dhe temave të ndryshme, mediat e pavarura vlerësohen dukshëm më mirë si nga qytetarët ashtu edhe nga përfaqësuesit e mediave dhe organizatave joqeveritare. Është një gamë shumë më e gjerë e bashkëbiseduesve që përfshin ekspertë, analistë, qytetarë ose figura publike të cilët shprehin pikëpamjet e tyre për çështje të ndryshme dhe tema të rëndësishme për qytetarët, si dhe për zhvillimet socio-politike ndikimi i të cilave është i panjohur për pjesën më të madhe të komunitetit serb në Kosovë. Segmenti që u mungon mediave të pavarura janë përfaqësuesit e institucioneve dhe autoriteteve lokale. Shumica e gazetarëve dhe redaktorëve që morën pjesë në intervista deklarojnë se nuk janë në gjendje të arrijnë deri tek bashkëbiseduesit nga qeveria. Zakonisht nuk ka përgjigje në pyetjet e parashtruara, domethënë gazetarët nuk kanë mundësi t'u bëjnë pyetje në ngjarje zyrtare. Po ashtu, disa media kishin përvoja negative në këtë drejtim, të tilla si mosftimi në konferenca për shtyp dhe ngjarje publike ose refuzimi për t'iu përgjigjur në pyetjet e tyre.

Deklaratat nga përfaqësuesit e institucioneve janë një segment tjetër që mund të përmirësojë ndjeshëm përmbajtjen mediatike. Gazetarët dhe

redaktorët theksojnë se e kanë të vështirë t'iu qasen institucioneve, pra në përgjigjet e tyre në pyetjet gazetareske. Praktika aktuale në punën e gazetarëve është plot me shembuj të dërgimit të një numri të madh të kërkesave për qasje të lirë në informacione me rëndësi publike, përkatësisht pamundësisë për një përgjigje në kohë. Gazetarët përmendin përvoja të tilla si marrja e përgjigjeve formale, që nuk japin informacion në lidhje me punën e institucionit që i është drejtuar pyetja. Problemet me përkthimet e dokumenteve zyrtare në gjuhën serbe janë ato që gazetarët dhe asociacionet e gazetarëve i kanë vënë në pah si problem për vite me rrallë. Me kalimin e kohës, ka pasur një përmirësim në këtë fushë, por përfaqësuesit e mediave ndajnë mendimin se duhet shumë më shumë përpjekje nga institucionet e nivelit qendror për të adresuar plotësisht këtë çështje.

Nuk na ftuan në konferenca. Ka pas raste kur vendosnim kampe para institucioneve. Ndiqim atë që po ndodh, dhe hamendësonim se ku dhe kur mund të shfaqen. (gazetare, portali në internet)


Më duket se ata nuk do të japin deklarata as për (mediat) e tyre. Vetëm dërgojnë njoftime. (qytetarët)

As zërin e tyre nuk e njohim. Njoftimet vetëm lexohen. (redaktore, portali në internet)

Shmangin çdo mundësi që dikush t'iu parashtrorë pyetje. Pse nuk u realizua ajo që keni njoftuar, ajo që keni premtuar, sa kushtojnë punimet, si janë zgjedhur kontraktorët? (gazetare, portal)

Pavarësia e mediave, pra mundësia për të vendosur në mënyrë të pavarur se si të raportojnë për një numër shumë të konsiderueshëm të qytetarëve nuk ekziston. Ekziston një numër dukshëm më i madh i atyre qytetarëve që besojnë se mediat nuk janë të pavarura. Gjithsej 60.8% e të anketuarve nuk pajtohen me qëndrimin se mediat vendosin në mënyrë të pavarur se si të raportojë, nga të cilat 23.4% nuk pajtohen aspak dhe 37.4% të tjerë nuk pajtohen. Në të kundërt, rreth një e katërta e të anketuarve pajtohen me këtë qëndrim.

Grafiku 11. Besoj se mediat janë të pavarura dhe se vet marrin vendime për mënyrën e raportimit të tyre




Ndikimet në media nga politikanët lokalë dhe përfaqësuesit e qeverisë identifikohen nga qytetarët. Qytetarët konsiderojnë se varësia nga fondet buxhetore ndikon që mediat në raportimet e tyre të monitorojnë dhe transmetojnë aktivitete pa ndonjë pyetje apo kritikë. Nga ana tjetër, gazetarët dhe përfaqësuesit e mediave të financuara nga donatorët theksojnë se ata nuk kanë presione dhe ndikime për mënyrën e raportimit të tyre.

Duhet t'i dëgjojnë ata që i financojnë. (qëndrimi i përgjithshëm i qytetarëve në fokus grupe)

Nuk ka presion nga donatorët. Nuk ka ndodhur që të jemi në një situatë ku dikush të na kërkojë të ndryshojmë diçka ose të tërheqim diçka që kemi botuar. (redaktor, portali në internet)

Grafiku 12. Shpesh vërej se disa lajme të rëndësishme nuk janë në media



Gjuha e urrejtjes

Në kuptim më të gjerë, mungesa e gjuhës së urrejtjes është një segment i rëndësishëm që potencion informimin objektiv dhe promovimin e tolerancës dhe qasjes ndaj të tjerëve.

Gazetarët dhe redaktorët nga mediat serbe që morën pjesë në hulumtim theksojnë se kur analizojmë këtë fenomen, duhet të kemi parasysh ndarjen e mediave të pavarura dhe mediave që financohen nga buxhetet lokale. Vlerësimi i përgjithshëm është se nuk ka ndonjë gjuhë të konsiderueshme të urrejtjes në mediat serbe në Kosovë, por nëse ka, vjen nga media të financuara nga buxheti. Përfaqësuesit e mediave janë të mendimit se ekziston një vetëdije e zhvilluar për standardet në punën e gazetarëve dhe se raste sporadike ndodhin kryesisht në ueb faqet e mediave dhe në një masë më të vogël në programet e transmetuara në radio ose televizion.

Vlerësimi i përbashkët i mediave dhe qytetarëve është se gjuha e urrejtjes nuk drejtohet në mënyrë të konsiderueshme ndaj pjesëtarëve të kombeve të tjerë në Kosovë. Nëse shikojmë të dhënat për

perceptimin e gjuhës së urrejtjes ndaj shqiptarëve, goranëve ose romëve si grupeve më në numër, mund të shohim një përqindje pak më të lartë ndaj shqiptarëve ku 11% e qytetarëve deklarojnë se gjuha e urrejtjes kryesisht ekziston, përkundrajt 4.9% ndaj romëve ose 2.7% ndaj goranëve.

Gjuha e urrejtjes që u vërejt kryesisht ka të bëjë me pjesëtarët e komunitetit serb, domethënë është drejtuar drejt asaj pjese me të cilën nuk kanë qëndrime të njëjta politike, përkatësisht lidhur me bashkëpunimin me përfaqësuesit e komuniteteve tjera.

Kështu, gazetarët përmendin shembuj të përdorimit të emrave nënçmues për pjesëtarët e shumicës, por mbi të gjitha tregojnë për praktikën akoma të pranishme të etiketimit të të ashtuquajturve "tradhtarë të vendit" dhe "mercenarë të huaj". Shembujt më ekstremë të këtij lloji të raportimit janë sulmet dhe raportimet negative për Olliver Ivanoviqin.

Drejt përdrejtë nuk ka gjuhë të urrejtjes në mediat serbe. Dikur ishte përdorur një term nënçmues në TV Most, por më vonë u hoq nga portali. Më

shumë është tek toni, se komuniteti tjetër shihet me një ton negativ. Sipas opozitës. Por kushdo që thotë ose deklaron diçka në kundërshtim me mendimin qeverisës bashkohet me opozitën. (redaktore, portali në internet)

Ndonjëherë ka, në mediat pro-qeveritare. Këtu përdoren fjalët nënçmuese për shqiptarët, në portale. Kishte edhe ankesa për këtë. (korrespondent, RTK)

Gjuha e urrejtjes? Ekziston në sensin që është e pranishme në njoftimet e Listës Serbe. Jo në sensin që mediat japin një përmbajtje të tillë, por në trans-

metimin e saj. Mendoj se këtu ka shumë më pak, për shkak të situatës politike. (gazetar)

Qytetarët gjithashtu identifikojnë ekzistencën e disidentëve politikë si objekte të gjuhës së urrejtjes, plotësisht në 8.3%, dhe pjesërisht në 28.8% të përgjigjeve. Pak më pak se një e treta e qytetarëve besojnë se ekziston gjuha e urrejtjes ndaj serbëve që bashkëpunojnë me shqiptarët (7.4% plotësisht dhe 17.4% ekzistojnë kryesisht). Raportimi negativ për serbët që bashkëpunojnë me të huaj ekziston sipas mendimit të një të katërtës së qytetarëve të anketuar (5.8% plotësisht dhe 17.4% ekziston kryesisht).

Tabela 2. A ka dhe deri në çfarë mase ka gjuhë të urrejtjes ndaj popujve në vazhdim në mediat serbe në Kosovë?

	1	2	3	4	5	NO
Ndaj shqiptarëve	34,2	44	5,9	11	2,3	2,5
Ndaj goranëve	65,8	26,9	1,6	2,7	0,7	2,3
Ndaj romëve	56,6	31,5	3	4,9	1,7	2,3
Ndaj disidentëve politikë	28,1	25,5	6,5	28,8	8,3	2,7
Ndaj serbëve që bashkëpunojnë me të huaj	34,4	30,3	9,7	17,4	5,8	2,4
Ndaj serbëve që bashkëpunojnë me shqiptarët	30,8	27,6	8,7	23,2	7,4	2,3

1 Nuk ekziston fare; 2 - Kryesisht nuk ekziston; 3 - Neutrale; 4 - Kryesisht ekziston; 5 Ekziston plotësisht; NO - pa përgjigje; vlerat janë të shprehura në%.

Siguria e gazetareve

Siguria e gazetareve është një fushë e analizuar si një nga aspektet që ndikon në punën dhe lirinë e mediave për të trajtuar tema të caktuara, pra për të mbuluar ngjarje, fenomene dhe aktivitete të akterëve individualë. Të dhënat nga organizata dhe raporte të ndryshme që kanë të bëjnë me çështje sigurie tregojnë për probleme akoma të pranishme si frikësimi, kërcënimet apo edhe sulmet ndaj gazetareve ose pronës së medias.

Asociacioni e Gazetarëve të Serbisë në Kosovë për shumë vite paralajmëron për rrëmbimet dhe vrasjet ende të pazgjidhura të gazetareve dhe punëtorëve të mediave në Kosovë të kryera në periudhën nga viti 1998 deri në 2005.¹⁶

Sipas përfaqësuesve të mediave, perceptimi i sigurisë ndikon, mbi të gjitha, në zgjedhjen e temave me të cilat merren mediat.

Duke pasur parasysh se mjediset serbe në Kosovë janë të vogla dhe se gazetaret punojnë në ambiente ku të gjithë e njohin njëri-tjetrin, ata gjenden në një pozitë të pa lakmueshme sepse deri tek ta dhe anëtarët e familjes së tyre lehtë mund të arrihet. Pjesëmarrësit e hulumtimit deklarojnë se më shumë shqetësohen për personat e afërt, madje edhe më shumë sesa për sigurinë personale.

Manifestimet e kërcënimeve të sigurisë shihen kryesisht në presione delikate, pra paralajmërime indirekte për gazetare të caktuar. Pjesë e kërcënimit të sigurisë janë komentet dhe ofendimet publike ndaj mediave ose gazetareve, veçanërisht në llogaritë e mediave sociale që përshkruajnë gazetaret si "tradhtarë, jo patriotë, mercenarë të huaj ose ata që nuk e duan të mirën e shoqërisë".

Gazetarët dhe redaktorët theksojnë fenomenin e vetëcensurës, i cila ndodh për shkak të frikës, përvojave të mëparshme negative, qoftë personale

ose të kolegëve tjerë. Gazetarët me vetëdije vendosin të mos merren me disa tema, domethënë, në një masë të madhe ndikon në kujdes të shtuar gjatë raportimit. Gazetarët e interpretojnë këtë lloj kujdesi si "peshim" nëse dhe në çfarë mënyre t'i qasen çështjeve të caktuara, çfarë gjuhe dhe terminologjie të përdorin, pra, në çfarë mase të sjellin tema dhe fenomene të caktuara në lidhje me personalitete të veçanta nga jeta publike ose politike.

Korrupsioni është një temë që ndikon në kujdes më të madh të gazetareve. Gazetarët dhe redaktorët theksojnë se korrupsioni është një temë që mund t'i çojë ata në situata potencialisht të rrezikshme dhe se ende nuk është një temë e trajtuar në një mënyrë më të thellë në kuptim të realizimit të storjeve hulumtuese. Kjo nuk do thotë se nuk ka shkrime për këtë temë, por që gazetaret me shumë kujdes shkruajnë për skandalet ose lidhjet e mundshme të personave të caktuar dhe skandale të caktuara korrupsioni, pra, ata nuk janë në gjendje të merren më thellësisht me këtë temë. Një nga shpjegimet për këtë situatë është mos përgjigja e institucioneve, kështu që është e vështirë për gazetaret të vërtetojnë disa indikacione, pra të sigurojnë dëshmi në formë të vendimeve për prokurim publik, vendimeve të komisioneve të caktuara ose kontratave të lidhura, që do jenë të dobishme për punën e tyre.

Korrupsioni, patjetër. Të themi, të shprehet dyshimi se dikush është i involvuar në një rast. Rasti gjithashtu është i nivelit të korrupsionit. Sa më i lartë niveli, aq më i rrezikshëm është ai për gazetarin. (gazetare dhe redaktore, Mitrovicë)

Një gazetar më së shumti mund ta gjejë veten në telashe nëse shkruan për krim dhe korrupsion. Në lidhje me atë zonën gri. Këto janë tema praktikisht të pahapura në Kosovë. Politikanët nuk i shikojnë në mënyrë të favorshme gazetaret sepse ata mund të zbulojnë aferat e tyre, jo profesionalizmin... Gazetarët janë një faktor korigjues, ata duhet të bëjnë thirrje për përgjegjësi. (redaktore, Mitrovicë)

¹⁶ <https://balkaninsight.com/2020/02/11/otmice-i-ubistva-novinara-na-kosovu-nisu-pravilno-istrazeni/?lang=sr>


Vetëcensura. Ekziston ashtu që gazetarët të mendojnë në mënyrë parandaluese. Ata mendojnë se kjo mund të provokojë dikë. Më duket se ndonjëherë ka më shumë vetëcensurë sesa censurë. Të gjithë zgjedhin kufirin e tyre, për sa kohë që ndihen të sigurt. (redaktore, portali në internet)

Qytetarët në masë të madhe besojnë se ekziston një frikë mes gazetarëve për të shkruar të vërtetën për shkak të presioneve ndaj të cilëve ata janë të ekspozuar. Gjithsej dy të tretat e qytetarëve të anketuar ndajnë këtë mendim. Rreth 40.2% e të anketuarve pajtohen dhe 26.7% e tyre plotësisht pajtohen me këtë qëndrim. Këto të dhëna tregojnë perceptimin e qytetarëve për presionin ndaj çdo zëri të ndryshëm ose të kundërt në publik, ose atmosferën në të cilën liria e shprehjes nuk perceptohet në një nivel të lartë.

Rastet e sulmeve ndaj gazetarëve ose redaksive që kanë ndodhur në vitet e mëparshme janë në shumicën e rasteve ende pa epilog. Gjithashtu, edhe pas më shumë se një dekade, rastet e rrëmbimeve ose vrasjeve të gazetarëve nuk janë zgjidhur. Sipas mendimit të përfaqësuesve të mediave dhe shoqatave të gazetarëve, kjo është një shenjë e qartë se nuk ka qëllim dhe veprim të qartë të institucioneve për mbrojtjen e gazetarëve. Kështu, tregohet pakujdesi ndaj gazetarëve dhe u dërgohet një sinjal se në rast të shkeljes më serioze të sigurisë për mbrojtjen e tyre nuk mund të mbështeten në mënyrë të konsiderueshme.

Rasti i sulmit ndaj redaksisë nuk është zgjidhur. Dhe cili është mesazhi? Mesazhi është se nëse diçka ju ndodh, askush nuk do të jetë në gjendje t'ju mbrojtë. (gazetar, portali në internet)

Grafiku 13. Mendoj se gazetarët kanë frikë të shkruajnë të vërtetën për shkak të presioneve të ndryshme ndaj të cilave janë të ekspozuar



Pandemia Covid-19 dhe mediat

Pandemia e koronavirusit, si një temë mbizotëruese globale dhe lokale, zuri hapësirë të konsiderueshme në mbulimin mediatik gjatë vitit 2020. Mediat serbe në Kosovë, pavarësisht nga lloji dhe tipi i përmbajtjes që prodhojnë, e kanë trajtuar këtë temë në një masë të konsiderueshme. Mediat që merren me informacione të përditshme çdo ditë kanë publikuar të dhëna për numrin e personave të testuar dhe të infektuar, masat epidemiologjike dhe parandaluese, aspektet mjekësore dhe edukim, si dhe informacione për punën e institucioneve, institucioneve shëndetësore ose shërbyese.

Përfaqësuesit e mediave që morën pjesë në hulumtim janë të mendimit se gjatë pandemisë raportimi ishte adekuat dhe se qytetarët ishin në gjendje të merrnin informacioni i cili në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë prezantonte aspekte të ndryshme, të tilla si masat parandaluese, masat e shtabeve të krizave dhe rregullat e sjelljes, por edhe të kontestit global (të dhëna për situatën në vendet e tjera të rajonit, Evropës dhe botës).

Bashkëpunimi me institucione, posaçërisht me ato përgjegjëse për pandeminë (institucionet shëndetësore, MPB, Ministria e Shëndetësisë) gjatë pandemisë vlerësohet si më i mirë krahasuar me situatën e zakonshme. Pas javëve të para në të cilat u vendosën rregullat dhe u kanalet e komunikimit me mediat, komunikimi i ndërsjellë dhe sigurimi i informacionit për mediat kishte një rrjedhë normale. Gazetarët dhe redaktorët janë të mendimit se pandemia ka potencuar mundësinë e zhvillimit të marrëdhënieve të reja, shumë më cilësore midis mediave dhe institucioneve dhe se praktikat e mira që janë vendosur duhet të vazhdojnë.

Ishin të shkëlqyeshme, duhet të them (institucionet). Është potencuar se informacioni i mirë mund t'u jepet mediave dhe qytetarëve. Ishte një mënyrë për t'u avancuar. Për të përmirësuar bashkëpunimin tonë. (gazetar, korrespondent i RTK-së)

Raportimi ishte i mirë. Kishte konfuzion tek ne sepse u aplikuan masat nga Beogradi dhe Prishtina. Me

numrat e letërnjoftimit... orari i lëvizjes ndryshonte çdo tre ditë, dhe arritën ta transmetojnë atë, i përditësuan informatat. (gazetar, portali në internet).


Informacioni i kërkuar nga qytetarët ishte ai në lidhje me udhëzimet për lëvizje, veçanërisht jashtë kufijve, sepse midis qytetarëve kishte konfuzion se si të udhëtonin jashtë vendit, veçanërisht gjatë stinës së verës dhe pushimeve. Qytetarët e Serbisë gjithashtu iu drejtuan mediave duke kërkuar informacion se si të udhëtonin në Shqipëri, pra, për dokumentet e nevojshme në vendkalimet administrative në Jarinjë dhe Brnjak.

Ekzistenca e masave paralele në lidhje me epideminë nga institucionet kompetente nga Prishtina dhe Beogradi ishte një sfidë si për mediat ashtu edhe për qytetarët. Media raportonin edhe për masat e Ministrisë së Shëndetësisë nga Prishtina dhe masat e miratuara nga Shtabi i Krizave nga Republika e Serbisë, dhe për shkak të numrit të madh të masave dhe udhëzimeve, qytetarëve iu transmetua një sasi e madhe e informacionit dhe udhëzimeve. Në këtë mënyrë, barra binte mbi gazetarët që duhej të përpunonin dhe të përçonin informacionin për audiencën e tyre në mënyrën më të qartë të mundshme, por edhe mbi qytetarët që duhej ta përpunonin këtë informacion dhe të harmonizonin sjelljen ndaj tyre.

Përmirësimi cilësor i marrëdhënieve të ndërsjella nga pjesëmarrësit e mediave interpretohet si natyrë "apolitike" e temës, pra, duke u përqendruar në një qëllim që tejkaloi mosmarrëveshjet dhe përqendrimit në ndarjet politike që ekzistojnë në shoqëri.

Qytetarët kanë shprehur interes të konsiderueshëm për informacionin në lidhje me pandeminë e koronavirusit, pavarësisht nga moshja e tyre. Rezultatet nuk janë të habitshme duke pasur parasysh ndikimin e pandemisë në shëndetin e njeriut. Një e treta e të anketuarve nga të gjitha kategoritë e moshave janë shumë të interesuar dhe mesatarisht pak më pak se një e treta janë disi të interesuar për këtë lloj informacioni. Devijimi i vetëm në trend ekziston midis të anketuarve më të rinj të cilët shprehin një normë të lartë interesimi në një përqindje dukshëm më të ulët (22%).

Grafiku 14. Prezantimi i shpërndarjes së interesimit të të anketuarve sipas informacionit dhe temave të disponueshme në media - Pandemia e koronavirusit - moshë




Në anketë, qytetarët konfirmuan një vlerësim pozitiv të mbulimit mediatik të pandemisë Covid-19. Qytetarët potencojnë kënaqësinë më të madhe për raportim ndaj mediave nga Serbia, pothuajse dy të tretat e tyre (63.8%, ku 41.9% janë të kënaqur dhe 21.9% janë shumë të kënaqur).

Gjithashtu, një përqindje shumë e lartë (52.7%) e qytetarëve shprehin mbështetjen e tyre për mediat serbe nga Kosova (52.7% janë të kënaqur dhe 7.2% janë shumë të kënaqur).

Ndaj mediave shqiptare, pakënaqësia më e madhe shprehet nga 30% e të anketuarve, ndërsa

31.4% e të anketuarve shprehin pakënaqësi të lartë. Ne jemi të mendimit se kjo çështje duhet të adresohet më thellësisht, duke pasur parasysh se numri i qytetarëve që informohen nga këto media nuk është i lartë. Ajo që mbetet e panjohur është nëse ky qëndrim formohet nga inercia, bazuar në intolerancën e ndërsjellë midis komuniteteve që ekziston tek një pjesë e qytetarëve, dhe të hulumtohen elementet e raportimit që shkaktuan pakënaqësi tek qytetarët. Në një masë më të vogël, informacioni i marrë nga mediat e huaj vlerësohet negativisht. Pak më shumë se një e katërta e të anketuarve theksojnë se janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur.

Grafiku 15. Sa jeni të kënaqur me mbulimin mediatic gjatë pandemisë së koronavirusit?



4. Përfundimet

Vlerësimi i përgjithshëm i hapjes së mediave serbe për opinione dhe qëndrime të ndryshme që rezultojnë nga hulumtimi i qëndrimeve të qytetarëve përmes anketave dhe grupeve të fokusit, si dhe intervistave të thelluara me gazetarë, redaktorë, pronarë të mediave dhe përfaqësues të OJQ-ve është shumë i mirë. Në përputhje me kapacitetet e tyre njerëzore dhe materiale, mediat vlerësohen si të suksesshme në promovimin e temave të ndryshme, opinioneve, qëndrimeve të akterëve dhe grupeve të ndryshme sociale, si dhe përfaqësuesve të komunitetit shumicë në Kosovë. Ky vlerësim i referohet mediave të pavarura, përkatësisht atyre mediave që nuk mbështeten në financim nga buxheti. Audiencës i paraqitet skena politike në Kosovë, rrymat dhe efektet e procesit të dialogut, jeta ekonomike dhe shoqërore, sportet, si dhe ngjarjet kulturore dhe artistike. Gazetarët e këtyre mediave përpunojnë të shikojnë ngjarjet dhe fenomenet përmes pasojave në jetën e përditshme të qytetarëve të mbështetura me komentet e ekspertëve dhe analistëve.

Mediat e financuara nga buxheti kritikohen për një perspektivë më të ngushtë kur bëhet fjalë për numrin dhe larminë e akterëve, përkatësisht dominimin e temave politike dhe raportimin bazuar në transmetimin e deklaratave nga përfaqësuesit e qeverisë lokale pa rishikuar në mënyrë kritike aktivitetet dhe efektet e tyre.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e situatës socio-politike në shoqërinë kosovare, ekzistencën e ndarjeve të konsiderueshme midis shumicës shqiptare dhe komunitetit serb, por edhe faktin që në

komunitetet serbe mediat lokale nuk janë burimi i vetëm i informacionit për qytetarët, mund të flasim për ndikim të kufizuar në formimin e diskurseve publike, pra imponimit të temave ose pikëpamjeve të caktuara për publikun e gjerë. Mediat janë padyshim një faktor i rëndësishëm në krijimin e agjendës (eng. agenda setting), por në rastin e vlerësimit të ndikimit dhe kontributit të hapjes së komunitetit serb ndaj pikëpamjeve dhe akterëve nga komuniteti shumicë, duhet të kemi parasysh edhe ndikime tjera sociale dhe politike, rëndësinë e të cilave pjesëmarrësit në hulumtim e konsiderojnë pjesërisht të kufizuar krahasuar me ndikimin e politikës ose mediave nga Serbia.

Ekziston një ndikim pozitiv në hapjen e komunitetit duke promovuar tema lokale, shembuj të bashkëpunimit midis pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme, problemet me të cilat përballen pjesëtarët e komunitetit shumicë, duke paraqitur pikëpamjet e ekspertëve dhe analistëve, me vërtetje se mbyllja dhe inercia e institucioneve lokale dhe qendrore, problemet gjuhësore (mungesa e përkthimeve adekuate të dokumenteve në serbisht) dhe injorimi nga politikanët e vështirësojnë punën gazetareske dhe mundësinë për raportim të thelluar dhe gjithëpërfshirës.

Efektet negative që ndikojnë në hapjen e mediave dhe aftësinë e tyre për të promovuar një gamë më të gjerë temash, qëndrimesh ose opinioneve individuale është sigurisht ndikimi i politikës ose refuzimi për të siguruar bashkëpunim dhe informacionin e nevojshëm dhe komunikimin disi të përmirësuar por ende të pazhvilluar me institucionet lokale dhe

qendrore. Si rezultat, mediat nuk janë në gjendje të sigurojnë të dhënat e nevojshme për të mbuluar tema të caktuara, pra të sigurojnë burime të besueshme dhe të verifikueshme të informacionit. Hapja e medias gjithashtu ndikohet negativisht nga perceptimi gazetaresk i sigurisë, pra vetëcensura, një mekanizëm i vetëmbrojtjes gazetareske në një mënyrë që gazetarët të shmangin raportimin për tema të caktuara që ata i shohin si potencialisht të rrezikshme, të tilla si korrupsioni ose krimi.

Konkluzionet që mund të jenë të rëndësishme për përmirësimin e punës së mediave serbe në Kosovë kanë të bëjnë me besimin e ulët të identifikuar në to, besimin e tanishëm që disa tema të rëndësishme janë harruar, dyshimet në vërtetësinë e informacionit ose që mediat favorizojnë parti të caktuara. Perceptimi i vërejtur mund të jetë një pikë fillestare për shqyrtimin dhe zhvillimin e udhëzimeve për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme për një bashkëpunim më të mirë me qytetarët dhe rivendosjen e besimit të ndërsjellë.



Ekziston një ndikim pozitiv në hapjen e komunitetit duke promovuar tema lokale, shembuj të bashkëpunimit midis pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme, problemet me të cilat përballen pjesëtarët e komunitetit shumicë, duke paraqitur pikëpamjet e ekspertëve dhe analistëve, me vërejtje se mbyllja dhe inercia e institucioneve lokale dhe qendrore, problemet gjuhësore (mungesa e përkthimeve adekuate të dokumenteve në serbisht) dhe injorimi nga politikanët e vështirësojnë punën gazetareske dhe mundësinë për raportim të thelluar dhe gjithëpërfshirës.

5. Rekomandime

Rekomandimet e përgjithshme

TË PËRMIRËSOHET TRANSPARENCA NË PUNËN E MEDIAVE SERBE NË KOSOVË – Krijimi i një regjistri të mediave sipas llojit (radio stacione, televizione dhe media online), pronësia transparente e shtëpive mediatike, si dhe burime transparente të financimit perceptohen si parakushte për rikthimin e besimit të qytetarëve dhe institucioneve në media dhe punën e tyre. Mungesa e një strukture të qartë të pronësisë dhe mënyrës së financimit i kontribuon laikëve dhe lë hapësirë për interpretime të ndryshme dhe perceptime negative për mediat dhe punën e tyre nga qytetarët.

SPECIALIZIMI I MEDIAS shihet si një kusht i domosdoshëm për përmirësimin e punës së shtëpive ekzistuese mediatike në kuptim të qëndrueshmërisë. Gazetarët dhe redaktorët që morën pjesë në hulumtim potencojnë ekzistencën aktuale të një numri të madh të paqëndrueshëm të mediave dhe situatën ku pothuajse të gjithë merren me të njëjtat tema dhe të njëjtin lloj të përmbajtjes, gjë e cila shteron mediat dhe pengon diversitetin e përmbajtjes së tyre.

Specializimi rekomandohet për llojin e përmbajtjes së prodhuar (programi i lajmeve, analiza dhe gazetaria hulumtuese, raportet dhe programi dokumentar, artikujt), dhe fushave tematike në punë. Kështu, mediat mund të përdorin kapacitetet e tyre në një mënyrë më efikase dhe kompetente. Gazetarët mund të thellojnë njohuritë dhe kuptimin e tyre për temën e zgjedhur, dhe kështu të jenë në gjendje t'u paraqesin qytetarëve në mënyrën më

të mirë informacionin për ngjarjet në shoqëri, ose efektet e proceseve më të gjera në jetën e tyre të përditshme.

RRJETI MEDIATIK DHE SHKËMBIMI I PËRMBAJTJEVE MEDIATIKE - krijimi i rrjetit mediatik shihet nga përfaqësuesit e mediave si një mekanizëm që do të përmirësonte ndjeshëm prodhimin e përgjithshëm mediatik të mediave serbe në Kosovë. Kështu, mediat mund të përdorin kapacitetet e tyre në një mënyrë më të qëllimshme, gazetarët mund t'i përkushtohen trajtimit të temave ose proceseve të caktuara, dhe kështu të njohin më mirë fushat që mbulojnë. Organizimi i tillë do të rezultonte në paraqitjen e informacionit për qytetarët në një mënyrë të arsyetuar, pra përveç qasjes informuese në raportim, mediat do të ishin në gjendje të përshinin një aspekt analitik dhe arsimor.

Rekomandime për media

RISHIKIMI I ZAKONEVE TË AUDIENCËS do t'u sigurote mediave informatën kthyesë mbi përmbajtjen e prodhuar dhe do të mundësonte zhvillimin e strategjive për të përmirësuar punën e tyre.

EKZAMINIMI I NEVOJAVE MEDIATIKE TË AUDIENCËS do të ofronte njohuri për llojet e informacionit dhe temat me rëndësi për qytetarët. Në këtë mënyrë, do të vendoset një komunikim më i mirë, do të identifikohen më mirë nevojat e qytetarëve dhe do të vendoset besimi i ndërsjellë duke përshtatur prodhimin mediatik me ato nevoja.

TRAJTIMI I TEMAVE LOKALE, veçanërisht storjet për qytetarët dhe përvojat të tyre, individët e suksesshëm, idetë e suksesshme biznesi, *historitë e bashkëpunimit* me përfaqësuesit e komunitetit shumicë, si dhe temat jo politike që janë në fokusin e të gjithë shoqërisë kosovare, do të përmirësonin ndjeshëm larminë e përmbajtjes mediatike dhe do t'u ofronin qytetarëve një perspektivë të re në perceptimin e jetës shoqërore dhe politike.

BASHKËPUNIMI I GAZETARËVE përmes shoqatës *joformale ose punës së shoqatës* shihet si një mënyrë e pranueshme për edukim të mëtejshëm përmes shkëmbimit të njohurive dhe përvojës, trajnimit për standarde ose mundësi ligjore për ushtrimin e të drejtave në fushën e lirisë së shprehjes, por gjithashtu edhe si fuqizim i kapaciteteve avokuese tek institucionet përmes veprimeve të përbashkëta.

Respektimi i standardeve profesionale të raportimit gjatë raportimit.

Regjistrimi dhe raportimi i rasteve të presionit, sulmit ose shkeljes së të drejtave të gazetarëve.

Bashkëpunimi i përfaqësuesve të mediave dhe asociacioneve të mediave me përfaqësuesit e Prokurorisë, Policisë dhe Gjykatës me qëllim të edukimit të tyre të mëtejshëm dhe kuptimit të zbatimit të legjislacionit në fushën e lirisë së fjalës dhe punës gazetareske.

Rekomandime për institucione

Sigurimi i zbatimit të legjislacionit i referohet punës së mediave, posaçërisht dispozitave ligjore që përcaktojnë qasjen e mediave në dokumentet publike, përgjigjen adekuate dhe në kohë të institucioneve dhe qeverive lokale ndaj mediave. Marrja e përgjigjeve brenda afateve të përcaktuara me ligj, marrja e përgjigjeve në pyetjet specifike dhe mundësia e marrjes së përgjigjeve në gjuhën serbe janë ende vështirësi të cilat gazetarët i hasin në punën e tyre të përditshme. Zbatimi më adekuat i parimit të qasjes së lirë në informacion me rëndësi publike do të përmirësojë raportimin për punën e institucioneve dhe kështu ato do të jenë më pranë qytetarëve.

REAGIMI NË KOHË NDAJ RASTEVE TË RAPORTUARA presioni, sulmi ose cenimi të sigurisë së gazetarëve është një rekomandim që synon krijimin e një ambienti më të sigurt për gazetarët dhe krijimin e një imazhi të qartë në publik që praktikantët e tilla janë të papranueshme nga cilado palë (autoritete, politikanë ose individë).

SIGURIMI I FONDEVE TË QËNDRUESHME PËR TË FINANCIAR PUNËN E MEDIAVE TË PAKICAVE dhe vendosja e procedurave të qarta për alokimin e tyre është një mekanizëm i besueshëm për të mbështetur punën e mediave. Sigurimi i financimit transparent si dhe sigurimi i pavarësisë në raportimin e transmetuesit publik dhe të redaksisë së programit në gjuhën serbe. Gjithashtu, sigurimi i disponueshmërisë së programeve në gjuhën serbe në të gjitha komunat ku jetojnë serbët.

Rreth nismës

"Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - Open" është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Open zbatohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin serb në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

- Nisma do të adresojë në mënyrë specifike analizën dhe vlerësimin e ndikimit të organizatave civile dhe politike mbi demokracinë dhe hapjen e komunitetit serb në Kosovë.
- Do të analizohen dhe vlerësohen demokracia dhe hapja e institucioneve, politikave publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.
- Këto analiza do të ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Organizatave me përvojë dhe të dëshmuara të shoqërisë civile, për të arritur qëllime të përgjithshme dhe specifike do të realizojnë tetë (8) analiza sektoriale.

Fushat që partnerët tanë do të analizojnë në vitin 2020 janë:

Mediat Sa ndikojnë mediat në gjuhën serbe në Kosovë në shkallën e hapjes, qasjes dhe pluralizmit të opinionëve dhe temave? Kjo fushë hulumtohet nga **Qendra Mediale** dhe **Bota bardh e zi**.

Shoqëria civile Si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në hapjen dhe demokracinë e komunitetit serb dhe shoqërisë në Kosovë në përgjithësi? Me këtë temë merret **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Partitë politike Demokracia dhe pluralizmi i partive politike serbe të Kosovës, hapja e tyre për të marrë pjesë në sistemin politik të Kosovës dhe për të kontribuar në avancimin dhe përmirësimin e politikave publike. Në këto çështje do të fokusohet **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Qendra Mediale**

Përgjegjësia e institucioneve Përmes monitorimit të kuptohet më mirë pozita e komunitetit serb në Kosovë dhe se sa të hapur janë institucionet ndaj problemeve të serbëve. Analiza realizohet nga **Bota bardh e zi** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Siguria Sa ndikon ndjenja e sigurisë në hapjen e komunitetit serb ndaj institucioneve të sigurisë së Kosovës? Në këtë pyetje kërkon përgjigje **Qendra Humane Mitrovica**.

Ekonomia Sa janë të hapura entitetet ekonomike nga komunitetet me shumicë serbe për integrim në ekonominë e Kosovës? Këtë fushë e analizon **Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial (InTER)**.

Të drejtat e pakicave Si të arrihet një shoqëri më e hapur duke vënë në pah boshllëqet në zbatim të së drejtave të pakicave? Kjo temë shqyrtohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave**

Procesi i dialogut dhe normalizimi i marrëdhënieve

Kosovë-Serbi - Deri në çfarë mase përfaqësohet dhe cilat janë qëndrimet e komunitetit serb të Kosovës lidhur me ndikimin dhe të ardhmen e procesit? Kjo analizë realizohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietnik**.

Në fund të ciklit Open 2020 do të publikohet raporti i konsoliduar „**Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës**“ duke i vendosë rezultatet dhe përfundimet e analizave bazë të anëtarëve të iniciativës Open në një kontekst më të gjërë socio-politik të Kosovës.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

